



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Në bazë të nenit 108 të Ligjit për arsimin e lartë (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2011, 15/2013 dhe 24/2013), të Rregullores për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të studentëve në Universitetin e Evropës Juglindore dhe në bazë të Vendimit të Senatit të datës 19 shkurt të vitit 2013, Këshilli i Rektorit i Universitetit të EJKL më 12 prill të vitit 2013 shpall:

## KONKURS

**Për regjistrimin e studentëve në fakultetet e Universitetit të Evropës Juglindore për vitin akademik 2013/2014, sipas cikleve të studimeve**

### I. CIKLI I PARË I STUDIMEVE

#### 1. Numri i studentëve të rregullt në vitin akademik 2013/14, në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze

I.1 Studime të rregullta	Shq	Maq	Ang	Vendi i studimit	Çmimi i studimeve për semestër
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>					
Drejtësi	90	-	-	TE	650€
	30	30	-	SHK	
Kriminalistikë dhe siguri	50	-	-	TE	
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË</b>					
Biznes dhe ekonomi	100	30	-	TE	900€
	50	30	-	SHK	
Agrobiznesi	20	-	-	TE	
Sistemet e informacionit dhe menaxhmenti <sup>1</sup>	-	-	25	SHK	1000€
<b>FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE I SHKENCAVE POLITIKE</b>					
Administrimi publik	90	30	-	TE	650€
	25	25	-	SHK	
Shkencat politike	40	-	-	TE	
	25	25	-	SHK	
Studime evropiane	20	-	-	TE	
	-	20	-	SHK	
Studime evropiane <sup>2</sup>	-	-	25	SHK	1000€
Lidershipi dhe puna me rininë në shoqëri <sup>3</sup>	-	-	20	TE	

<sup>1</sup> Ky program studimor zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin e Londrës – program i jashtëm (UoL) “London School of Economics” (LSE) – External Program. Pas përfundimit të studimeve studentët do të marrin “diplomë të dyfishtë” - dy diploma (nga Fakulteti i Londrës për ekonomi dhe nga UEJL). Kriteret për regjistrim janë paraparë në mënyrë të veçantë në konkurs. Studimet realizohen në gjuhën angleze.

<sup>2</sup> Ky është program i përbashkët studimor me Universitetin e Lubjanës (një nga top 500 universitetet sipas rangimit në nivel botëror). Diploma është e pranuar gjithashtu edhe Republikën e Sllovenisë si diplomë e Universitetit të Lubjanës.

<sup>3</sup> Ky program është përgatitur në bashkëpunim me Universitetin Jönköping - Suedi.

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE					
Shkencat kompjuterike	90	20	-	TE	900€
	25	25	-	SHK	
Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (Inxhinieria kompjuterike)	20	20	20	TE	900€
Informatika e biznesit	-	-	40	TE	1000€
	-	-	30	SHK	
Informatika e mediave	-	-	20	SHK	
DEPARTAMENTI I STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKË <sup>4</sup>					
Menaxhimi bashkëkohor bankar	-	-	25	TE	1000€ (bursa nga kompanitë)
Menaxhimi bashkëkohor i ndërmarrjeve	-	-	25		
Informatika e aplikuar për kompanitë e TI	-	-	25		
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE I KOMUNIKIMIT					
Gjuhë dhe letërsi shqipe	20	-	-	TE	650€
Gjuhë dhe letërsi angleze	-	-	60	TE	
	-	-	30	SHK	
Gjuhë dhe letërsi gjermane	-	-	25 GJER	TE	
Komunikimi ndërkombëtar	20	-	-	TE	
	-	20	-	SHK	

## 2. Numri i studentëve në studimet me korrespondencë

Në fakultetet e UEJL-së, në vitin e parë të studimeve deridiplomike, në vitin akademik 2013/2014, do të regjistrohet një numër i caktuar studentësh me korrespondencë sipas programit me distancë - 30% nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt të paraparë me konkursin në programet vijuese studimore:

I.2 Studime me korrespondencë	Vendi i studimit	Çmimi i studimeve për semestër
FAKULTETI I DREJTËSISË		
Drejtësi	TE, SHK	450€
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË		
Informatika e biznesit	TE, SHK	650€
FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE I SHKENCAVE POLITIKE		
Administrimi publik	TE, SHK	450€
Shkenca politike	TE	
FAKULTETI I SHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE		
Shkencat kompjuterike	TE, SHK	650€
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE I KOMUNIKIMIT		
Gjuhë dhe letërsi angleze	TE, SHK	450€
Komunikimi ndërkombëtar	SHK	

Studimet me korrespondencë sipas programit me distancë janë studime të pavarura në përputhje me udhëzimet dhe standardet e universitetit. Regjimi i studimit është si vijon:

- në fillim të semestrit studentët kanë ligjëratë hyrëse me profesorët e lëndës përkatëse;

<sup>4</sup> Këto programe për studime të integruara me praktikën, realizohen me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) në kuadër të programeve të dyfishta të Universitetit. Këto programe profesionale realizohen: 50% të mësimdhënies në universitet (me profesorë ndërkombëtarë) dhe 50% në kompani. Studentëve të cilët do të studiojnë në këto programe do t'u ofrohet bursë e plotë nga kompanitë dhe punësimi i këtyre të diplomuarve është 100%. Studimet janë në gjuhën angleze. Më shumë e informata në [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk)

- lëndët e shkathtësive (si p.sh. gjuha angleze dhe teknologjia e informacionit do të organizohen me ligjërata të rregullta, njëherë në dy javë, pas orarit të punës, varësisht nga niveli i njohurive);
- përmes sistemit për menaxhim elektronik “Libri” (libri.seeu.edu.mk) do të merren instruksione për mësimin, kriterin e notimit, materialet e nevojshme dhe do të ketë mundësi pjesëmarrjeje në forume elektronike;
- në përfundim të semestrit do të organizohet një seminar intensiv me profesorët e lëndëve përkatëse.

#### Shënim (për pjesën I.1 dhe I.2)

Në rast të paraqitjes së kandidatëve në numër më të madh se numri i paraparë në këtë konkurs dhe nëse vlerësohet se ata i plotësojnë kriteret dhe standardet e kërkuara për regjistrim në UEJL, atëherë Këshilli i rektorit mund të vendosë që të pranojë më së shumti deri më 20% prej tyre nga numri i paraparë me konkurs.

Në rast se paraqiten më pak se 20 kandidatë në programin e caktuar studimor, Universiteti ka të drejtë të mos e fillojë mësimin për programin përkatës studimor, kurse kandidatëve të paraqitur t’ua ofrojë mundësinë të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.

Rregullat e studimit për të gjithë studentët janë të shpallura në “Përmbledhjen e akteve normative për qeverisjen dhe regjimin e studimeve”. Kjo përmbledhje gjendet në ueb faqen e universitetit.

### 3. Kriteret për regjistrim të studentëve në ciklin e parë

#### 3.1. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

- a) Të drejtë regjistrimi në studime deridiplomike kanë kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose arsim gjegjës me të dhe që kanë kaluar maturën shtetërore.
- b) Në rast se në afatin e parë të regjistrimit nuk plotësohet numri i paraparë i studentëve me këtë konkurs, atëherë të drejtë regjistrimi në afatin e dytë, (përveç atyre që kanë kaluar maturën shtetërore), kanë edhe kandidatët e gjimnazeve që kanë kaluar maturën shkollore dhe kandidatët nga shkollat e mesme profesionale që kanë dhënë provimin përfundimtar.
- c) Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose arsimin gjegjës me të para vitit 2008, kanë të drejtë të regjistrohen vetëm në bazë të suksesit të shkollës së mesme.
- d) Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose arsimin gjegjës me të jashtë Republikës së Maqedonisë, kanë të drejtë të regjistrohen, vetëm në bazë të suksesit të shkollës së mesme. Ata ndërkohë duhet t’i nostrifikojnë diplomën dhe dëftesat në Ministrinë e arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë.
- e) Vlerësimi i suksesit nga shkolla e mesme, matura shtetërore dhe nga matura shkollore për nxënësit e gjimnazeve të përgjithshme apo i provimit përfundimtar për ata që kanë kryer shkollat profesionale (për kandidatët në afatin e dytë të pranimit), shprehet me anë të pikëve. Në bazë të pikëve do të bëhet renditja e kandidatëve të pranuar.

- f) Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt apo me korrespondencë me financim të studimeve.
- g) Përparësi gjatë pranimit të studentëve me korrespondencë do të kenë kandidatët që kanë status të të punësuarit dhe që kanë sukses më të mirë nga shkollimi i mesëm. Të punësuarit duhet ta dokumentojnë statusin e tyre.

### 3.2. Njohja e gjuhëve

- a) Të gjithë kandidatët do t'i nënshtrohen testimit për njohuritë e tyre për shkallën e njohjes së gjuhës angleze. Ky testim nuk ka karakter eliminues, por nevojitet për ta përcaktuar nivelin e njohjes së gjuhës angleze.
- b) Për programet me mësim në gjuhën angleze, kriteret minimale janë: TOEFL ITP min. 460 pikë (versioni në formë të shkruar që ofrohet në UEJL)/ TOEFL IBT min. 57 pikë (versioni në formë kompjuterike)/IELTS min. 5 pikë ose rezultat ekuivalent në testi n institucional për njohje të gjuhës angleze nga Qendra e Gjuhëve, UEJL.

### 3.3. Regjimi i studimit

Regjimi i studimeve i zgjedhur për të cilat përcaktohet kandidati që në fazën e aplikimit, mbetet regjimi i studimeve deri në diplomim, pa mundësi të ndryshimit të tij.

### 3.4. Vlerësimi i suksesit

Vlerësimi i suksesit nga shkolla e mesme dhe nga matura shtetërore do të shprehet me anë të pikëve. Vlerësimi i suksesit do të bëhet sipas dy kriterëve:

- sukcesi i treguar në shkollën e mesme (gjimnazi apo shkollimi i mesëm profesional) dhe
- sukcesi i treguar në provimin e maturës

### 3.5. Paraqitja dhe regjistrimi në ciklin e parë të studimeve

#### Afatet për paraqitje

Kandidatët e interesuar mund të paraqiten para periodës për regjistrim, duke filluar nga **6 maj 2013** deri më **30 gusht 2013**. Kandidatët që aplikojnë para provimit të maturës shtetërore e ruajnë të drejtën të studiojnë në programin në të cilin kanë aplikuar, duke pasur parasysh se programet studimore janë konkurrencte dhe nuk mund të regjistrohen më shumë studentë se numri i paraparë për regjistrim me konkurs. Këta kandidatë duhet t'i dorëzojnë dokumentet e shënuara në pikët: 1, 2, 3, 4 (vetëm dëftesat e tri viteve të kryera), 6 dhe 7.

Regjistrimi i këtyre kandidatëve do të zyrtarizohet pas kompletimit të dokumentacionit.

#### Paraqitja e kandidatëve

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet e parapara me konkurs.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e poshtëshënuara, në ndërtesën 802, në kampusin e universitetit ose nëpërmjet postës, në adresën vijuese:

Universiteti i Evropës Juglindore, Bul. Ilindenska, nr. 354, 1200 Tetovë, Maqedoni
--

Për më shumë detaje kontaktoni Zyrën për pranim:

Tel: +389 44 356 188; +389 44 356 091; E-mail: admissions@seeu.edu.mk
---

## Dokumentet për paraqitje në konkurs dhe regjistrim

Të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë në vitin akademik 2013/2014 duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e poshtëpërmendur:

1. Formularin e plotësuar (i cili mund të merret në Zyrën për pranim të universitetit ose në *web* faqen zyrtare: [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk))
2. Fletëpagesën në shumë prej 1500 MKD (25 Euro)

Detaje për pagesën në denar:

Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Zhiro llogaria:	200-0008775390-10

Detaje për pagesën në euro:

Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Adresa e bankës:	Bul. M.Tito bb, Tetovo 1200, Macedonia
Zhiro llogaria:	0009009090
IBAN:	MK07200000900909026
SWIFT:	STOBMK2X

3. Biografi e shkurtër/letër përcjellëse e cila do të përmbajë më së paku 500 fjalë. Në këtë ese duhet të përmenden arsyet pse studenti aplikon në Universitetin e EJL.
4. Dëftesat origjinale nga të gjitha vitet (ose kopje të verifikuara te noteri).
5. Vërtetim për rezultatet nga matura shtetërore, gjegjësisht matura shkollore apo provimi përfundimtar.
6. Certifikatë e lindjes
7. Fotokopje e letërnjoftimit ose e pasaportës

### Shënim:

Studentët që kanë kryer shkollimin e mesëm para vitit 2008 apo jashtë Republikës së Maqedonisë duhet të dorëzojnë diplomë origjinale për kryerjen e arsimit të mesëm.

Studentët e transferuar në mënyrë plotësuese duhet të sigurojnë transkript të notave nga institucioni paraprak i arsimit të lartë.

## II. CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

### 1. Regjistrimi i studentëve në studimet e ciklit të dytë për vitin akademik 2013/14 (pasdiplomike) dyvjeçare, sipas modelit 3+2, dhe njëvjeçare sipas modelit 4+1

II. 1 Cikli i dytë i studimeve (Modeli: 3+2)	Numri i studentëve	Gjuha e studimit	Vendi i studimit	Çmimi i studimeve për semestër
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>				
E drejta penale	70	SHQ, MAQ	TE	900 €
E drejta civile	30	SHQ, MAQ	TE	
Studime të sigurisë	20	SHQ, MAQ	TE	
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË</b>				
Financa dhe kontabilitet	35	SHQ, MAQ	TE	900 €
Menaxhment	35	SHQ, MAQ	TE	
Marketing	35	SHQ, MAQ	TE	
Menaxhimi i projekteve	25	ANG	TE	
Ndërmarrësia dhe zhvillimi ekonomik vendor	20	ANG	TE	
Aadministrim biznesi (MBA) <sup>5</sup>	15	ANG	TE	1000 €
<b>FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE I SHKENCAVE POLITIKE</b>				
Administrimi publik	25	SHQ, MAQ	TE	900 €
Shkencat politike	20	SHQ, MAQ	TE	
Diplomaci	35	SHQ, MAQ	SHK	
Studime evropiane	20	SHQ	TE	
	20	MAQ	SHK	
Zhvillimi i shoqërisë civile	20	ANG	SHK	
Studime evropiane <sup>6</sup>	25	ANG	SHK	1000 €
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>				
Menaxhimi i bazave të të dhënave	20	SHQ	TE	900 €
Informatika e biznesit	25	ANG	SHK	
Cloud Computing dhe aplikacionet mobile të ueb-it	30	ANG	SHK	
Inxhinieria softuerike dhe telekomunikacioni	40	ANG	TE, SHK	
Aplikimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në procesin mësimor	40	SHQ, MAQ	TE, SHK	
<b>FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT</b>				
Mësimdhënia e gjuhës angleze	40	ANG	TE	900 €
Studime gjermane	15	GJER	TE	
Studime albanologjike	15	SHQ	TE	
Komunikimi ndërkombëtar	20	SHQ, MAQ	SHK	
Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim	15	SHQ	TE	
<b>INSTITUTI I AMBIENTIT JETËSOR DHE I SHËNDETIT</b>				
Menaxhmenti shëndetësor dhe shëndeti publik	25	SHQ, MAQ	TE	900 €
Menaxhimi i mjedisit jetësor	20	SHQ, MAQ	TE	

<sup>5</sup> Master of Business Administration (MBA) – realizohet në bashkëpunim me Kelley School of Business (KSB) - Universiteti i Indianës, SHBA, i cili është e ranguar në TOP 10 MBA programet në SHBA (<http://kelley.iu.edu/about/rankings.htm>). Përveç diplomës së magjistraturës nga UEJL, studentët pajisen edhe me Certifikatë specializimi nga KSB. Një semestër realizohet në tërësi nga mësimdhënës të KSB nëpërmjet programit të tyre on-line Kelley Direct.

<sup>6</sup> Program studimor i përbashkët me Universitetin e Lubjanës (një nga top 500 universitetet e ranguar në nivel botëror). Diploma është e pranuar gjithashtu edhe në Republikën e Sllovenisë si diplomë nga Universiteti i Lubjanës.

INSTITUTI PËR HULUMTIM SHKENCOR "MAX VAN DER STOEL"				
Studime të së drejtës dhe politikës ndërkombëtare				
E drejta ndërkombëtare Marrëdhënie ndërkombëtare E drejta biznesore ndërkombëtare	50	ANG	TE, SHK	900 €

II.2 Cikli i dytë (Model: 4+1)	Numri i studentëve	Gjuha e studimit e	Vendi i studimit	Çmimi i studimeve për semestër
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>				
E drejta penale	20	SHQ, MAQ	TE	900 €
E drejta civile	20	SHQ, MAQ	TE	
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE I EKONOMISË</b>				
Financa	20	SHQ, MAQ	TE	900 €
Menaxhment	20	SHQ, MAQ	TE	
Marketing	20	SHQ, MAQ	TE	
<b>FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE I SHKENCAVE POLITIKE</b>				
Studime të diplomacisë	20	SHQ, MAQ	TE	900 €
Zhvillimi i shoqërisë civile	20	ANG	SHK	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>				
Zhvillimi i softuerit dhe aplikacioneve	20	ANG	TE	900 €

Në rast se paraqiten më pak se 15 kandidatë në programin studimor, universiteti ka të drejtë mos të fillojë me programin përkatës studimor, kurse kandidatëve gjegjësisht do t'u ofrojë mundësi të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.

## 2. Kriteret për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë

### 2.1. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

- Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve pasdiplomike të ciklit të dytë, sipas modelit 3+2 (dyvjeçare) kanë kandidatët që kanë diplomë (të nostrifikuar)<sup>7</sup> universiteti (të ciklit të parë), ose diplomë gjegjësisht nga studimet trevjeçare (180 ECTS kredi) apo katërvjeçare (240 ECTS).
- Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve pasdiplomike të ciklit të dytë, sipas modelit 4+1 (dysemestral), kanë kandidatët që kanë diplomë (të nostrifikuar) universiteti (të ciklit të parë), ose diplomë gjegjësisht nga studimet katërvjeçare (240 ECTS kredi).
- Lëndët do të jenë të rregullta dhe modulare sipas sistemit: 50% nga planprogrami mësimor i fakultetit përkatës do të ofrohet në formë të rregullt, ndërsa pjesa tjetër e programit do të mund të kryhet me studime vetjake (të udhëzuara nga mësuesit). Lëndët e rregullta do të ofrohen çdo të dytën javë pas orës 16:00, ndërsa të shtunën nga ora 8:00, me qëllim që t'u përshtaten edhe kandidatëve që janë në marrëdhënie të rregullt pune. Ndërkaq, në rastet e lëndëve modulare (kur kemi profesorë të huaj), ligjëratat do të jenë intensive.
- Përparësi do të kenë studentët të cilët gjatë studimeve të ciklit të parë kanë arritur notën mesatare 8.00 e më lartë.
- Në rast se në programin përkatës studimor nuk paraqitet një numër i mjaftueshëm i kandidatëve, atëherë në atë program nuk do të organizohet mësim.

<sup>7</sup> Kandidatët që kanë kryer jashtë Republikës së Maqedonisë sipas Ligjit për arsim sipëror janë të obliguar në një afat prej gjashtë muajsh ta bëjnë nostrifikimin e diplomës në Ministrinë e arsimit të RM. Për përgjigje eventuale negative ose për mos marrje të përgjigjes, kandidatit do t'i ndërpriten studimet pa asnjë përgjegjësi nga ana e UEJL.

- f) Në rastin kur kandidati e ka mbaruar ciklin e parë të studimeve në një lëmi që nuk është adekuate me programin studimor në të cilin konkurren, atëherë komisioni i fakultetit përkatës do t'i caktojë kushtet për kriteret plotësuese që duhen për plotësimin e diturive paraprahe për t'u regjistruar në programin e ri studimor të ciklit të dytë.

## 2.2. Njohja e gjuhëve

- a) Të gjitha programet studimore për ciklin e dytë të studimeve (3+2 ose 4+1) ofrohen në gjuhën shqipe, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze. Megjithatë, pa marrë parasysh gjuhën e programit, Universiteti ka të drejtë të ofrojë një pjesë ligjëratash apo lëndësh në gjuhën angleze, prandaj njohja e gjuhës shqipe, maqedonase dhe angleze është e nevojshme, kurse njohja e së paku dy nga këto gjuhë të përmendura në nivel akademik, është e domosdoshme.
- b) Për programet me mësim në gjuhën angleze, kriteret minimale janë: TOEFL ITP min. 460 pikë (versioni në formë të shkruar që ofrohet në UEJL)/ TOEFL IBT min. 57 pikë (versioni në formë kompjuterike)/IELTS min. 5 pikë ose rezultat ekuivalent në testi n institucional për njohje të gjuhës angleze nga Qendra e Gjuhëve, UEJL.

## 2.3. Paraqitja dhe regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve

### Afatet për paraqitje

Afati i aplikimit për kandidatët është nga **6 maj 2013** deri më **14 shtator 2013**.

### Paraqitja e kandidatëve

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet e parapara me konkurs.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e përmendura më poshtë, në ndërtesën 802, në kampusin universitar ose nëpërmjet postës, në adresën:

Universiteti i Evropës Juglindore, Bul. Ilindenska, nr. 354, 1200 Tetovë, Maqedoni

Për më shumë detaje kontaktoni Zyrën për pranim:

Tel: +389 44 356 091; +389 44 356 188; E-mail: admissions@seeu.edu.mk

### Dokumentet për paraqitje në konkurs dhe regjistrim

Të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë në vitin akademik 2013/2014 duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e poshtëshënuar:

1. Formularin e plotësuar (i cili mund të merret në Zyrën për pranim të universitetit ose në *web* faqen zyrtare: [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk))
2. Fletëpagesën në shumë prej 1500 MKD (25 Euro)

Detaje për pagesën në denar:

Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Zhiro llogaria:	200-0008775390-10

Detaje për pagesën në euro:



Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Adresa e bankës:	Bul. M.Tito bb, Tetovo 1200, Macedonia
Zhiro llogaria:	0009009090
IBAN:	MK07200000900909026
SWIFT:	STOBMK2X

- Biografi e shkurtër/letër përcjellëse e cila do të përmbajë më së paku 500 fjalë. Në këtë ese duhet të përmenden arsyt pse studenti aplikon në Universitetin e EJL.
- Diplomë origjinale universitare (e nostrifikuar) dhe të gjitha transkriptat origjinale (diploma shtesë, nëse ka) nga cikli i parë i studimeve (ose kopje të noterizuara).
- Certifikatë e lindjes
- Fotokopje e letërnjoftimit ose e pasaportës.

## STUDIMET "ON-LINE"

### 1. Regjistrimi i studentëve sipas modelit "on-line" në UEJL për vitin akademik 2013/14 është si vijon:

Studimet ONLINE <sup>8</sup>	Numri i studentëve	Çmimi i studimeve për semestër
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>		
<b>CIKLI I PARË</b>		
Shkencat kompjuterike	20	650 €
Biznes dhe ekonomi		
<b>CIKLI I DYTË</b>		
Informatika e biznesit	20	650 €
<b>FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE I KOMUNIKIMIT</b>		
<b>CIKLI I DYTË</b>		
Mësimdhënia e gjuhës angleze	20	650 €

### 2. Kriteret për regjistrim

- Afatet dhe kriteret për regjistrim të studentëve në studime sipas modelit ON-LINE janë të njëjta si në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.
- Përmbajtja kryesore e lëndës do të dërgohet ON-LINE përmes shërbimeve elektronike: LMS Libri dhe Adobe Connect. Komunikimi do të bëhet përmes webmail-it dhe Skype-it.
- Studentët do të udhëzohen për mënyrën e studimit vetanak, me kriteret e vlerësimit, materialet e nevojshme dhe me mundësitë për të marrë pjesë në forumet e diskutimit.

Për informata më të detajuara kontaktoni eLearning Centre (UJEL Ndërtesa. 701):

Tel: +389 44 356 017; +389 44 356 188; E-mail: [elc@seeu.edu.mk](mailto:elc@seeu.edu.mk)

<sup>8</sup> Programet do të ofrohen në gjuhën angleze dhe ato ndryshojnë nga programet e rregullta studimore të akredituara vetëm nga mënyra e ofrimit të mësimdhënies.

### III. CIKLI I TRETË I STUDIMEVE - SHKOLLA E DOKTORATËS

#### 1. Regjistrimi i studentëve në ciklin e tretë të studimeve (6 semestra), për vitin akademik 2013/14

III.1 Cikli i tretë i studimeve	Numri i studentëve	Gjuha e studimit	Çmimi i studimeve për semestër
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË</b>			
Administrim biznesi	12	ANG	1000€
Ekonomi		ANG	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>			
E-Teknologji	15	ANG	1000€
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>			
E drejta penale	20	SHQ, MAQ	1000€
E drejta civile		SHQ, MAQ	
E drejta ndërkombëtare		ANG	
<b>FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE I SHKENCAVE POLITIKE</b>			
Qeverisja dhe administrata publike	15	SHQ, MAQ	1000€
Shkenca politike		SHQ, MAQ	
<b>FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT</b>			
Gjuhë dhe letërsi shqipe	18	SHQ	1000€
Gjuhë dhe letërsi angleze		ANG	
Gjuhë dhe letërsi gjermane		GJER	
<b>INSTITUTI I MJEDISIT JETËSOR DHE SHËNDETIT</b>			
Menaxhimi i mjedisit jetësor	9	SHQ, MAQ, ANG	1000€

#### 2. Kriteret për regjistrim të studentëve në ciklin e tretë të studimeve

##### 2.1. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

- Të drejtë regjistrimi kanë kandidatët që kanë arritur notën mesatare 8.00 dhe më lart, gjatë studimeve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve nga lëmi përkatës, kandidatë të cilët kanë akumuluar minimum 300 ECTS dhe që janë nga lëmi përkatës dhe që kanë publikuar punime shkencore dhe kanë njohje adekuate të gjuhës angleze.
- Në rastin kur aplikuesi ka përfunduar ciklin e dytë në një lëmi që nuk është adekuate me fushën në të cilën paraqitet për fitimin e titullit shkencor të ciklit të tretë në të cilin konkurren, atëherë për kushtet eventuale plotësuese të përshtatjes së njohurive paraprake për regjistrim në programin studimor do të vendosë komisioni i formuar nga fakulteti përkatës.
- Kandidatët që kanë diplomuar në universitetet jashtë Republikës së Maqedonisë sipas Ligjit për arsim të lartë janë të obliguar që ta bëjnë nostrifikimin e diplomës në Ministrinë e arsimit të RM, ku do të kenë edhe ndihmën e Shërbimit studentor të universitetit.

##### 2.2. Njohja e gjuhëve

- Për programet studimore që ofrohen në anglisht, kërkesat minimale janë: TOEFL ITP min. 460 pikë (versioni në formë të shkruar që ofrohet në UEJL)/ TOEFL IBT min. 57 pikë (versioni në formë kompjuterike)/IELTS min. 5 pikë; ose të kenë arsim paraprakisht të kompletuar në gjuhën angleze.

- b) Prioritet për pranim në programet e ofruara në gjuhët lokale do të kenë kandidatët të cilët të paktën njohin një gjuhë të huaj. Dëshmia e njohurive të gjuhëve të huaja mund të jetë një certifikatë ndërkombëtare, ose një certifikatë e lëshuar nga Qendra e gjuhëve të UEJL-së, ose një diplomë për arsim të kryer më parë në gjuhën e huaj përkatëse.

### 2.3. Paraqitja dhe regjistrimi në ciklin e tretë të studimeve

#### Afatet për paraqitje

Afati i aplikimit për kandidatët është nga **6 maj 2013** deri më **14 shtator 2013**.

#### Paraqitja e kandidatëve

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në konkurs. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e përmendura në vazhdim, në ndërtesën 802, në kampusin e universitetit ose me postë në adresën e mëposhtme:

Universiteti i Evropës Juglindore, Bul. Ilindenska, nr. 354, 1200 Tetovë, Maqedoni
--

Për informata më të detajuara kontaktoni Zyrën për pranim:

Tel : +389 44 356 188; E-mail: admissions@seeu.edu.mk
---

#### Dokumentet për paraqitje në konkurs dhe regjistrim

Të gjithë aplikantët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm për vitin akademik 2013/2014:

1. Formularin e plotësuar (i cili mund të merret në Zyrën për pranim të universitetit ose në *web* faqen zyrtare: [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk))
2. Fletëpagesën në shumë prej 1500 MKD (25 Euro)  
Detaje për pagesën në denar:

Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Zhiro llogaria:	200-0008775390-10

Detaje për pagesën në euro:

Pranuesi:	UEJL
Emri i bankës:	STOPANSKA BANKA
Adresa e bankës:	Bul. M.Tito bb, Tetovo 1200, Macedonia
Zhiro llogaria:	0009009090
IBAN:	MK07200000900909026
SWIFT:	STOBMK2X

3. Biografinë, duke përfshirë listën e materialeve të publikuara të kandidatit;
4. Kërkesë që duhet të përmbajë fushën e studimeve ku do të bëhen hulumtime për disertacionin dhe të dhëna për qëllimet e hulumtimit;
5. Letër motivimi;
6. Certifikatë për rezultatet e njohjes së gjuhës angleze;
7. Fotokopje e letërnjoftimit ose e pasaportës;
8. Diplomën origjinale nga cikli i parë dhe cikli i dytë i studimeve (kopje të nostrifikuara për diplomat jashtë Republikës së Maqedonisë).